

VENDIM
Nr.392, datë 5.10.1998

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË SHQYRTIMIT DHE TË MIRATIMIT NË KUVENDIN POPULLOR TË PROJEKTKUSHTETUTËS, TË PARAQITUR NGA KOMISIONI PARLAMENTAR PËR HARTIMIN E PROJEKTKUSHTETUTËS

Komisioni Parlamentar për Hartimin e Projektkushtetutës, i ngritur me vendimin nr.339, datë 3.9.1997 të Kuvendit Popullor, në përputhje me nenin 44 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", pas një pune të gjatë dhe të hapur, duke u mbështetur në përvojën pozitive të procesit kushtetutës të filluar që në vitin 1991, si dhe në asistencën dhe mbështetjen e madhe të komunitetit ndërkombëtar, në mënyrë të veçantë të Komisionit të Venecias, hartoi tekstin përfundimtar të Projektkushtetutës, i cili u depozitua në Kuvend më datë 2.10.1998. Në mbështetje të nenit 148 të Rregullores së Kuvendit Popullor, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet programi i shqyrtimit dhe miratimit në Kuvendin Popullor të Projektkushtetutës, të parqitur nga Komisioni Parlamentar për Hartimin e Projektkushtetutës, si vijon:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. Paraqitja dhe miratimi i projektprogramit në seancë plenare | 5.10.1998
e hënë, ora 1700 |
| 2. Prezantimi i Projektkushtetutës nga Komisioni Kushtetues | 8.10.1998
e enjte, ora 1800 |
| 3. Pyetje për tekstin e Projektkushtetutës dhe dhënien e përgjigjeve | 9.10.1998
e premte, ora 1000 |
| 4. Diskutim në parim i Projektkushtetutës | 9-10.10.1998
e premte, e shtunë |
| 5. Shqyrtimi i Projektkushtetutës nga komisionet parlamentare dhe grupet parlamentare, si dhe bërja e amendamenteve: amendamentet i paraqiten komisionit për hartimin e Projektkushtetutës | 5-13.10.1998 |
| 6. Shqyrtimi i amendamenteve nga Komisioni Kushtetues | 14-15.10.1998 |
| 7. Shqyrtimi nen për nen i Projektkushtetutës në senacë plenare dhe miratimi i amendamenteve eventuale | 16-18.10.1998 |
| 8. Miratimi në tërësi i Projektkushtetutës | 20.10.1998 |
| 9. Procedura për propozimin, marrjen e vendimit dhe shpalljen e referendumit për miratimin e Kushtetutës | 20-22.10.1998 |
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.